

Kondicionerët e ajrit

# Ngrohje dhe ftohje

Njësia me montim në mur

ETIKETË  
ENERGJIE  
E KLASIT  
PËR TË GJITHË  
GAMËN **A**

- » **Sistemi i pompës ngrohëse**
- » **Shtimi dhe heqja e lagështisë në një sistem të vetëm**
- » **Sjell në dhomë ajër të freskët, të kondicionuar**
- » **Cilësi e përmirësuar e ajrit në ambientet e brendshme**
- » **Përfshihet teknologjia e inverterit**



[www.daikin.eu](http://www.daikin.eu)



FTXR-E

**Ururu**  
**Sarara**



Njësia split e kondicionerit të ajrit Ururu Sarara të Daikin, me sistemin e saj unik, mund të ngrohë dhe të ftohë, të shtojë dhe të heqë lagështinë, të ajrosë dhe të pastrojë ajrin e ambienteve të brendshme, të gjitha në të njëjtën kohë.

Pompat ngrohëse të Daikin janë zgjidhjet që përmbajnë ngrohjen dhe ftohjen në një, që nënkupton ngrohtësi të këndshme në dimër dhe freski në verë. Njësia e brendshme mund të përdoret për një aplikim çift - një njësi e brendshme e lidhur me një njësi të jashtme. Zgjidhja ideale për një jetesë të rehatshme në të gjitha stinët. E përkryer, pikërisht ashtu siç e dëshironi ju.

## Kombinim i efikasitetit më të lartë dhe komfortit gjatë gjithë vitit me një sistem të pompës ngrohëse



### A e dinit se...

Pompat ngrohëse ajër-ajër përdorin 3/4 e energjisë nga burime të rinovueshme: ajri i ambientit. Ky burim energjie është i rinovueshëm dhe i pashtershëm\*. Sigurisht, pompat ngrohëse përdorin edhe 1/4 energji elektrike që sistemi të funksionojë, por kjo energji elektrike mund të krijohet gjithnjë e më shumë edhe nga burimet e energjisë së rinovueshme (energji diellore, energji e erës, energji e ujit, biomasa). Efikasiteti i një pompe ngrohëse matet me COP (koeficienti i performancës) për ngrohjen dhe EER (raporti i efikasitetit të energjisë) për ftohjen. Pompat ngrohëse arrijnë COP dhe EER prej deri në 5,14 (për FTXR28E)!

\* Objektiv i BE-së COM (2008) /30

## Teknologjia e inverterit

Teknologjia e inverterit, e zhvilluar nga Daikin është një novacion i vërtetë në fushën e kontrollit të klimës. Parimi është i thjeshtë: inverterët rregullojnë energjinë e përdorur për t'u përshtatur me kërkesat aktuale. As më pak e as më shumë. Kjo teknologji ju ofron dy përfitime konkrete:


### ► Komfortin

Inverteri e shlyen investimin e tij shumë herë duke përmirësuar komfortin. Një sistem për kondicionimin e ajrit me inverter e rregullon vazhdimisht rendimentin e ftohjes dhe ngrohjes për t'u përshtatur me temperaturën e dhomës. Inverteri shkurton kohën e ndezjes së sistemit duke mundësuar që temperatura e dëshiruar e dhomës të arrihet më shpejt. Menjëherë sapo arrihet temperatura, inverteri siguron që ajo të mbetet konstante.

### ► Kursimin e energjisë

Meqenëse inverteri monitoron dhe rregullon temperaturën e ambientit sa herë që është e nevojshme, konsumi i energjisë bie me 30% krahasuar me sistemin tradicional me ndezje/fikje! (pa inverter)


### Funksionimi i ngrohjes:



# 5 teknika për trajtimin e ajrit në 1 sistem të vetëm


## 1. Shtim i lagështisë, edhe gjatë ngrohjes

Për shtimin e lagështisë, që në japonisht quhet "Ururu", lagështia përhithet nga njësia e jashtme dhe hyn në njësinë e brendshme nga ku shpërndahet në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë dhomën. Avantazhet e lagështisë janë parandalimi i dhimbjes së fytit dhe tharjes së lëkurës si dhe ngrohja e trupit të njeriut edhe në temperatura të ulëta duke reduktuar kështu kërkesën për ngrohje dhe konsumin e energjisë.



## 2. Heqja e lagështisë, pa rënie të temperaturës

Heqja e lagështisë, ose "Sarara" në japonisht, redukton lagështinë në ambientin e brendshëm pa ndikuar në temperaturën e dhomës, duke përzierë ajrin e ftohtë dhe të thatë me ajrin e ngrohtë. Kështu që nuk do të ketë më dhoma të nxehta dhe pa ajër!



## 3. Cilësi e përmirësuar e ajrit të ambienteve të brendshme falë teknologjisë së qarkulluesit të shpejtë



Gazrat e shkarkimit dhe erërat e pakëndshme largohen nëpërmjet njësisë së jashtme. Më pas njësia e brendshme pastron ajrin nga pluhuri, poleni, tymi i cigares dhe erërat e gatimit. Ajo gjithashtu shpërbën viruset dhe mykun.

## 4. Ajrosje, ajër i pastër edhe me dritare të mbyllura

Ajri i pastër, i kondicionuar vjen në dhomë pa humbje të freskisë ose ngrohjes. Temperatura e ajrit që del vendoset në nivelin e dëshiruar.

## 5. Sistemi i pompës ngrohëse

Ururu Sarara nuk ofron vetëm mundësinë e ftohjes në verë, por edhe ngrohjen gjatë dimrave të ftohtë.

# Dizajni dhe cilësia e teknologjisë

Ururu Sarara ka marrë çmimin e njohur "Good Design Award" (çmimi për dizajn të mirë), kriteri i vetëm i vlerësimit për dizajnin industrial në Japoni.



## Për komfortin tuaj personal

Janë përfshirë veçoritë e mëposhtme



**1. Modaliteti i caktuar për natën:** kursen energji duke parandaluar ftohjen ose ngrohjen e tepërt gjatë natës



**2. Modaliteti i komfortit:** parandalon që ajri i ftohtë ose i ngrohtë të fryjë direkt në trup



**3. Shpërndarje 3D e ajrit:** kombinim i rrotullimit automatik vertikal dhe horizontal në mënyrë që ajri të qarkullojë në mënyrë të njëtrajtshme edhe në dhoma të mëdha ose në kënde



**4. Funkionim i qetë si pëshpërimë:** zhurma e njësive të brendshme është aq e ulët sa mund të krahasohet me fëshfërimën e gjetheve

# Ngrohje dhe ftohje

NJËSITË E BRENDSHME				FTXR28E	FTXR42E	FTXR50E
Kapaciteti	ftohje	min~nom~maks	kW	1,55~2,8~3,60	1,55~4,2~4,60	1,55~5,0~5,50
	ngrohje	min~nom~maks	kW	1,30~3,6~5,00	1,30~5,1~5,60	1,30~6,0~6,20
Fuqia hyrëse	ftohje	min~nom~maks	kW	0,25~0,56~0,80	0,26~1,05~1,32	0,26~1,46~1,80
	ngrohje	min~nom~maks	kW	0,22~0,70~1,41	0,22~1,18~1,60	0,23~1,51~1,77
EER	ftohje			5,00	4,00	3,42
COP	ngrohje			5,14	4,32	3,97
Etiketa e energjisë	ftohje				A	
	ngrohje				A	
Konsumi vjetor i energjisë	ftohje		kWh	280	525	730
Dimensionet	lartësi x gjerësi x thellësi		mm	209x890x305		
Pesha			kg	14		
Ngjyra e panelit të përparmë				E bardhë		
Shkalla e qarkullimit të ajrit	ftohje	H/M/L/SL	m³/min	11,1/8,8/6,5/5,7	12,4/9,6/6,8/6,0	13,3/10,3/7,3/6,5
	ngrohje	H/M/L/SL	m³/min	12,4/9,8/7,3/6,5	12,9/10,2/7,7/6,8	14,0/11,1/8,3/7,3
Niveli i presionit të zhurmës	ftohje	H/M/L/SL	dB(A)	39/33/26/23	42/35/27/24	44/37/29/26
	ngrohje	H/M/L/SL	dB(A)	41/35/28/25	42/36/29/26	44/38/31/28
Niveli i fuqisë së zhurmës	ftohje		dB(A)	55	58	60
	ngrohje		dB(A)	57	58	60
Furnizimi me energji				1~220-240V/50Hz		
Telekomanda				infra të kuqe		
				ARC447A1		

NJËSITË E JASHTME				RXR28E	RXR42E	RXR50E
Dimensionet	lartësi x gjerësi x thellësi		mm	693x795x285		
Pesha			kg	48		
Kompresori			lloji	Rrotullues i mbyllur hermetikisht		
Fuqia e zhurmës	ftohje		dB(A)	60		62
	ngrohje		dB(A)	60	62	64
Freoni			lloji	R-410A		
Mbushja shitese e freonit				kg/m		
Diapazoni i funksionimit	ftohje	min~maks	°CDB	-10~43		
	ngrohje	min~maks	°CWB	-20~18		
Lidhjet e tubacioneve	lëng		mm	ø6,35		
	gaz		mm	ø9,52		
	kullim		mm	ø18		
Presioni i zhurmës	ftohje	l lartë	dB(A)	46	48	
	ngrohje	l lartë	dB(A)	46	48	50
Gjatësia minimale e tubacioneve				m		
Diferenca e lartësisë maksimale të instalimit				m		
Furnizimi me energji				1~ / 220~240V / 50Hz		

Shënime: 1) Etiketa e energjisë: shkalla nga A (më efiçasja) deri te G (më pak efiçasja) - 2) Konsumi vjetor i energjisë: bazuar në përdorimin mesatar prej 500 orë pune në vit me ngarkesë të plotë (= kushtet nominale). - 3) V1 = 1=, 220-240V, 50Hz - 4) Kapacitetet nominale të ftohjes bazohen në: temperaturën e brendshme 27°CDB/19°CWB • temperaturën e jashtme 35°CDB/24°CWB • gjatësinë e tubave të gazit ftohës 7,5m • ndryshimin e nivelit 0 m - 5) Kapacitetet nominale të ngrohjes bazohen në: temperaturën e brendshme 20°CDB • temperaturën e jashtme 7°CDB/6°CWB • gjatësinë e tubave të gazit ftohës 7,5m • ndryshimin e nivelit 0 m - 6) Njësitë duhet të zgjidhen mbi kapacitetin nominal. Kapaciteti maksimal është i kufizuar vetëm në periudhat e pikut. - 7) Niveli i presionit të zhurmës është matur përmes një mikrofoni të vendosur në një distancë të caktuar nga njësi (për kushtet e matjes: Ju lutemi referojuni manualeve të të dhënave teknike) - 8) Niveli i fuqisë së zhurmës është një vlerë absolute që tregon "fuqinë" që krijon një burim zhurmë.



Njësia e brendshme  
FTXR28,42,50E



Telekomandë me infra të kuqe  
ARC447A1



Njësia e jashtme  
RXR28,42,50E



Pozicioni unik i Daikin si prodhues i pajisjeve për kondicionimin e ajrit, të kompresorëve dhe freoneve, ka çuar në angazhimin e tij të drejtpërdrejtë në çështjet mjedisore. Për vite me radhë Daikin ka pasur i qëllim që të bëhet një lider në ofrimin e produkteve që kanë ndikim të kufizuar në mjedis. Kjo s'fido kërkon modele ekologjike dhe zhvillimin e një game produktesh dhe të një sistemi për menaxhimin e energjisë, të cilat rezultojnë në ruajtjen e energjisë dhe në zvogëlimin e mbetjeve.



Broshura aktuale është hartuar vetëm nëpërmjet informacionit dhe nuk përbën ndonjë ofertë detyruese për Daikin Europe N.V. Daikin Europe N.V. e ka hartuar përmbajtjen e kësaj broshure me njohuritë e saj më të mira. Nuk jepet asnjë garanci e shprehur ose e nënkuptuar për plotësinë, saktësinë, besueshmërinë ose përshatshmërinë për qëllime të veçanta të përmbajtjes së saj dhe të produkteve dhe shërbimeve të paraqitura këtu. Specifikimet i nënshtrohen ndryshimeve pa njoftim paraprak. Daikin Europe N.V. refuzon në mënyrë të qartë çdo përgjegjësi për dëmtim direkt ose indirekt, në kuptimin më të gjerë, i cili lind ose lidhet me përdorimin dhe/ose interpretimin e kësaj broshure. E drejta e autorit për të gjithë përmbajtjen është e Daikin Europe N.V.



Daikin Europe N.V. merr pjesë në Programin e Certifikimit Eurovent për Kondicionerët e Ajrit (AC), Paketat Ftohëse të Lëngshme (LCP) dhe Ventilkonvektore (FC), të dhënat e certifikuar të modeleve të certifikuara janë renditur në direktorinë Eurovent. Njësitë e shumfishta kanë certifikatë Eurovent për kombinimin deri në 2 njësi të brendshme.



Produktet Daikin shpërndahen nga: